



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prilato Received / Delivery	17-03	2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SLIMSTAR	2762/2023		115	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.88/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari - kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, Ilire Mehmeti-Shaqiri- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.88/2023 të datës 18.01.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi në kundër organit të punësimit Komuna e Prizrenit në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.88/2023 e datës 18.01.2023 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja, më datë 18.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 456/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me zhvillimin e procedurave të konkursit me numër reference RN00010357 për Grupin "Specialist i Burimeve Njerëzore", lidhur me pozitën "Zyrtar për Shërbime me Qytetarë" në Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrit, të shpallur nga Komuna e Prizrenit me datë 07.11.2022. Tutje ankuesja me datën 15.03.2023 përmes emailit zyrtar ka bërë plotësimin e ankesës lidhur me gabimin e emërtimit të pozitës sepse e njëjta ka qenë pjesë e konkursit për "Specialit të Administrimit të Përgjithshëm", e jo të konkursit "Specialist i Burimeve Njerëzore", duke e sqaruar se me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill ka bërë vetëm gabim teknik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullore Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 02.02.2023 ankesën e ankueses e ka



proceduar për përgjigje në ankesë tek Udhëheqësi i Personelit pranë Komunës së Prizrenit. Ndërsa, Këshilli më datë 07.03.2023 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në ankesë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës Për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër VK/2023 të datës 24.02.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.Nr.88 të datës 18.01.2023, të parashtruar nga ankuesja;

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën e parashtruar nga ankuesja drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 456/2023 të datës 18.01.2023; Emilin me numër të protokollit 2696/2023 të datës 15.03.2023 të drejtuar KPMSHCK-së; Emalin e datës 19.01.2023 të drejtuar KPMSHCK-së; Emalin me numër të protokollit 1321/2023 të datës 03.02.2023 të parashtruar nga ankuesja V.L drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Prova shtesë me numër protokollit 1321/2023 të datës 03.02.2023; Konkursin me numër reference RN00010357 për Grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm të shpallur nga Komuna e Prizrenit me datë 07.11.2022; Certifikatë e V.B e lëshuar nga "Management Training Consultancy" në muajin Maj 2016; Certifikatë e V.L e lëshuar nga Certifikatë e V.L e lëshuar nga lëshuar nga e lëshuar nga Certifikatë e V.L e lëshuar nga NDI; Certifikatë e V.L e datës 15.01.2001; Dokumentin e identifikimit; Letër reference e V.L e lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transferove me datës 20.05.2021; Diplomë e V.L e lëshuar nga Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"-Fakulteti Juridik me Nr.566 të datës 21.03.2019; Letër reference e V.L e lëshuar nga "Kosovar Youth Council"; E-mail zyrtar të datës 17.01.2023 për plotësim të ankesës nga KPMSHCK drejtuar ankueses; Njoftimi i rezultatit të verifikimit paraprak të datës 12.12.2022; Njoftimi i rezultatit të vlerësimit me shkrim të datës 13.01.2023; E-mail nga V.L për KPMSHCK me datë 19.01.2023; E-mail nga V.L për KPMSHCK me datë 19.01.2023; E-mail nga V.L për SIMBNJ me datë 13.01.2023; E-mail nga SIMBNJ për V.L me datë 13.01.2023; Vendimin me nr.1058-1/20233 të datës 12.10.2022 të lëshuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës për V.L; Certifikatën e lindjes e V.L me nr.L60081408 me datë 02.12.2022; Certifikatë e V.L e lëshuar nga NDI dhe USAID në muajin Mars 2018; Certifikatë e lëshuar nga NDI dhe USAID e muajit tetor 2018; Aplikacion i kandidates së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Diplome për Kryerjen e Shkollës së Mesme e lëshuar nga SH.M "Ymer Prizreni" me numër protokollit 1611 të datës 04.06.2011; Përgjigje në kërkesë e dërguar nga Komuna e Prizrenit për KPMSHCK-në me numër protokollit 2421/2023 e datës 07.03.2023; Vlerësimi i aplikantëve; Aplikacioni i kandidates V.L së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës të datës 01.12.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokollit 1287/2023 e datës 02.02.2023 dërguar nga KPMSHCK për Komunën e Prizrenit; E-mail i dërguar nga F.B për I.M.SH i datës 14.03.2023; E-mail i dërguar nga F.B për I.M.SH i datës 13.03.2023; Lista e kandidatëve të cilët kanë kaluar verifikimin paraprak për Konkursin me numër reference RN00010357 për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm e lëshuar me datë 12.12.2022; Vendim për formimin e komisionit të pranimit të lëshuar nga Komuna e Prizrenit me Nr.RN00010357/1 i datës 12.12.2022; Njoftimin për rezultatet përfundimtare të lëshuar nga Komuna e Prizrenit me datë 09.03.2023; Konkursin me numër reference RN00008819 për grupin Specialistë të Burimeve Njerëzore i



shpallur me datë 15.04.2022 nga Komuna e Prizrenit; Lista e aplikantëve për konkursin me numër reference RN00008819;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga ankuesja \_\_\_\_\_ ka konstatuar se ankesa e ankuses është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i provave, Kolegji ka gjetur se Komuna e Prizrenit me datë 07.11.2022 ka publikuar konkursin me Nr.Reference RN00010357 për grupin "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" respektivisht për pozitën "Zyrtar për Shërbime me Qytetar" pranë Drejtorisë për Gjeodezisë dhe Kadastër, ku afati për aplikim ka qenë nga data 28.11.2022 deri më datën 05.12.2022. Në këtë konkurs në bazë të shkresave të lëndës me datë 01.12.2022 ka aplikuar dhe ankuesja \_\_\_\_\_ e cila në bazë të Njoftimit për rezultatin e vlerësimit paraprak të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të datës 12.12.2022 i ka plotësuar kriteret e konkursit për grupin "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" dhe e njëjta është njoftuar se vazhdon procedurat e mëtutjeshme të konkursit. Ndërsa me Njoftimin e rezulttit të testimit me shkrim të datës 13.01.2023, ankuesja njoftohet se në testin me shkrim është vlerësuar me gjithsejtë 29 (njëzet e nëntë) pikë, dhe në bazë të dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ankuesja nuk e ka kaluar testin me shkrim dhe nuk mund të vazhdoj në fazën tjetër të vlerësimit gjegjësisht nuk mund të vazhdoj me procedurat e mëtutjeshme të konkursit.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se në konkursin në fjalë është bërë manipulim me rezultatet e vlerësimit me shkrim dhe mënyrën e njoftimi të rezulttit të intervistës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me vlerësimin e testit me shkrim i'u referuara dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 21 paragrafi 3 dhe 4 i cili përcakton se: „Testi me shkrim zhvillohet dhe vlerësohet në mënyrë elektronike” „4.Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë”, ndërsa sipas nenit 22, paragrafit 2 të rregullores se lartpërmendur është përcaktuar se: "Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën dyzet (40) pikë në testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit ", e që në rastin konkret në bazë të shkresave të lëndës Kolegji ka konstatuar se ankuesja është njoftuar përmes sistemit SIMBNJ me date 13.01.2023, lidhur me rezultatin e vlerësimit të testit me shkrim, ku e njëjta është vlerësuar me gjithsejtë 29 (njëzet e nëntë) pikë, me çka nënkuptohet se e ankuesja nuk ka arritur të kaloj në fazën tjetër të vlerësimit gjegjësisht nuk mund ti nënshtrohet vlerësimit të jetëshkrimit.

Sipas nenit 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përcaktohet se: "1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet", e në kuptim të kësaj baze ligjore rrjedhe se ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër një procesi të pranimit në shërbimin civil, parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës së brendshme të



ankesës tek organi përkatës që ka shpall procedurën e pranimit . Ndërlidhur me këtë paragrafi 4 i nenit 31 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës thekson se: „Ankesa ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurrimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, mund të paraqitet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës. Procedura e brendshme e ankesës, vlerësohet së është shteruar nëse: 4.1. kandidati i pakënaqur me rezultatet e verifikimit paraprak ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 15 të kësaj rregulloreje; 4.2. kandidati i pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 25 të kësaj rregulloreje, apo 4.3. kandidati është cenuar drejtpërdrejtë nga aktet me të cilat është zgjidhur ankesa e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 15, sipas paragrafit 6 të nenit 25 e më sipër, të kësaj Rregulloreje”.

Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji në bazë të shqyrtimit të provave të lëndës, konstaton se ankuesja edhe përkundër Njoftimit të datës 13.01.2023 të rezultatit të testimit me shkrim, nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës brenda tre (3) ditësh në Komisionin e Pranimit në Komunën e Prizrenit, gjegjësisht ankuesja në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil nuk ka sjell asnjë dëshmi që ka parashtruar ankesë në Komisionin e Pranimit kundër njoftimit të rezultatit të testit me shkrim të datës 13.01.2023, dhe këtë e ka konfirmuar edhe autoriteti punëdhënës në përgjigjen në ankesë të datës 07.03.2023, ku ka theksuar që: “... ankuesja të drejtën për ankesë e ka pasur edhe në mënyrë fizike, por edhe në mënyrë elektronike, mirëpo ankuesja nuk ka parashtruar asnjë ankesë pranë Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore lidhur me këtë konkurs”, si rrjedhojë bazuar në këtë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se kandidatit në procedurë të pranimit nuk i lejohet të parashtrojë ankesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa i shterur procedurat e brendshme të ankimit, mbi këtë bazë ankesa e ankueses e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: “Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t’i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe”, sepse ankuesja fillimisht duhej të ushtronte ankesë pranë Komisionit të Pranimit ashtu siç është përcaktuar me nenin 25 paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku thuhet se: “Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtrojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual”, kështu që pas konstatimit se ankuesja ka ushtruar ankese drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa shteruar procedurat e brendshme të ankimit, Kolegji në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, konstaton se ankesa me numër me numër A.nr.88/2023 e datës 18.01.2023 e parashtruar nga ankuesja është e papranueshme.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.88/2023

**Ilire Mehmeti-SHAQIRI**

*Procesmbajtëse*

**Malsore Gashi-BAJRAKTARI**

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses,
- Udhëheqësi i Agjencisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

